



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.40/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.SH. “E...” me seli në Lipjan, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati N.B nga Ferizaj, kundër të paditurës NPN “M...” me seli në Lipjan, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati A.T nga Lipjani, për përmbushje të detyrimit kontraktues të pagesës së çmimit për kryerjen e punëve instaluese të energjisë elektrike, duke vendosur lidhur me ankesat e ndërgjyqësve të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.158/15 i datës 23/12/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10/02/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa themelta ankesa e paditëses N.SH. “E...” me seli në Lipjan dhe ankesa e të paditurës NPN “M...” me seli në Lipjan dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.158/15 i datës 23/12/2019.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar V.EK.nr.158/15 i datës 23/12/2019, ka vendosur si në vijim: Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.SH. “E...” me seli në Lipjan, me pronar M.G, që paditëses në emër të mos përmbushjes së kontratës t’ia paguaj shumën në lartësi prej 32,091.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 07.11.2019 (data e përpilimit të ekspertizës), deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,178.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shumën prej 32.091.00 euro, me kamatë prej 8% duke filluar nga data 01/01/2015 e deri në pagesën definitive si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,894.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, pala e paditur në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Ndërgjyqësit nuk kanë paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesat janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja N.SH. "E..." me seli në Lipjan, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 07/04/2015, ka paraqitur padi kundër të paditurës NPN "M..." me seli në Lipjan, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se ndërgjyqësit ishin në raporte afariste sipas kontratës nr.53/2012, për instalimin e rrjetit të rrymës elektrike në objektin e të paditurës NPN "M...t", ku paditësja në cilësinë e punë kryerësit dhe e paditura në cilësinë e investitorit janë marr vesh që çmimi kontraktues të jetë në shumë prej 12 euro për metër katror, e po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se nga çmimi i tërësishëm i kësaj kontrate, e paditura ia ka dhënë në formë të kompensimit një banesë për çmim prej 35,964.00 euro dhe para të gatshme në shumë prej 17,732.00 euro, më tej në arsyetim të

aktgjykimit gjithashtu theksohet se me ekspertizën e elektroenergjetikes të punuar nga Y.Z është konstatuar se vlera për punë të kryera dhe furnizim me materiale për të cilën paditësja nuk është kompensuar është në lartësi prej 23,391.70 euro, ndërsa me ekspertizën e elektroenergjetikes e punuar nga grupi i eksperteve në përbërje nga: Prof.Dr.G.P, Prof.Dr.M.B dhe Prof.Dr.R.H, është vërtetuar se borxhi total për të cilën pala paditëse nuk është kompensuar dhe duhet paguar nga pala e paditur është në shumë prej 32,091.00 euro, të cilës ekspertizë gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin dhe ka vendosur si në dipozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 262 par.1 dhe nenin 382.2 të LMD-së ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se në mes palëve ndërfaqëse nuk ishte kontestuese fakti se të njëjtit ishin në raporte kontraktuale sipas Kontratës për instalimin e rryetit të rrymës elektrike në objektin e paditëses N.P.N. "M...", në atë mënyrë që paditësja në cilësinë e punë kryerësit ka kryer punime në objektin e të paditurës dhe kanë arritur marrëveshje që çmimi kontraktues të jetë 12 euro për m², pastaj në bazë të ekspertizës së elektroenergjetikes të punuar nga eksperti Y.B është konstatuar se paditësja ka kryer punime në vlerë prej 23,391.70 euro dhe e paditura nuk e ka

përmbushur detyrimin kontraktual, ndërsa me ekspertizën e elektro energjetikes të punuar nga grupi i eksperteve në përbërje nga: Prof.Dr.G.P, Prof.Dr.M.B dhe Prof.Dr.R.H është vërtetuar bindshëm dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike se punimet e realizuar nga paditësja në objektin e të paditurës arrijnë shumë e përgjithshme prej 32,091.00 euro, të cilën pagesë duhet ta përmbush e paditura, ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të paditurës se në rastin konkret duhet të ballafaqohen ekspertet për arsye se kemi dy mendime të kundërta, një pretendim i tillë sipas kësaj gjykate vlerësohet si i pa bazuar, nga fakti se ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve ka dhënë përgjigje të mjaftueshëm në raport me vërejtjet e të paditurës dhe si rrjedhojë gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka falur besimin ekspertizës gjyqësore të punuar nga grupi i eksperteve të elektros, me arsyetim se përmban elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i paditëses edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, pasi që kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale sepse dispozita e nenit 8 të LMD-së, parashohin se palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre ndërsa neni 245.1 i LMD-së, parasheh se kreditori në marrëdhënie detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi. Andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar.

I drejtë del te jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të tij në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike,

prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-

Ae.nr.40/20, me datën 10/02/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku